



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MARRËVESHJE

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë, 17.05.2019, Palët e mëposhtme:

Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT
Z. Edi Rama

dhe

Bashkia Vau Dejës, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Zef Hila

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27, 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.19, datë 17.05.2019, për objektin: “Ndërtim për pulari, Bashkia Vau Dejës”, bien dakord si më poshtë:

NENI 1
OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Vau Dejës për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Ndërtim për pulari, Bashkia Vau Dejës”, me zhvillues “J.R.E” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.19, datë 17.05.2019.



NENI 2 KOHËZGJATJA

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Vau Dejës, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Vau Dejës të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.19, datë 17.05.2019, për objektin: “Ndërtim për pulari, Bashkia Vau Dejës”, me zhvillues me zhvillues “J.R.E” sh.p.k.
 - dhe
 - ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave që shoqëron këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Vau Dejës drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Ndërtim për pulari, Bashkia Vau Dejës”, me zhvillues me zhvillues “J.R.E” sh.p.k.
 - ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
 - iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Ndërtim për pulari, Bashkia Vau Dejës”, me zhvillues “J.R.E” sh.p.k, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.19, datë 17.05.2019:
 - Leje Ndërtimi;
 - Certifikatë Përdorimi.



NENI 4

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

4.1 Palët do të zgjidhin të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

NENI 5

GJUHA E MARRVESHJESH

5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë

NENI 6

EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

6.1 Palët bien dakort se efektet juridike të kësaj marrëveshje do të fillojnë që në momentin e nënshkrimit të saj.

6.2 Kjo marrëveshje publikohet në fletoren Zyrtare

PALËT

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,

Z. Edi Rama



BASHKIA VAU DEJËS

Përfaqësuar nga,

Z. Zef Hila

